



P R O C E S V E R B A L

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, e mbajtur më 18.06.2021, me fillim në ora 10.00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i Kuvendit **Afrim Dina**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të përvendos, nënkyetarin **Fatmir Iska**, te nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtoret e drejtive, përfaqësues të mediave dhe të gjithë ju të pranishëm.

Të nderuar anëtarë të KPF-së, për këtë mbledhje propozoj këtë :

R E N D D I T E

1. **Aprovimi i Procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
2. **Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2024;**
3. **Shqyrtimi i Draft Strategjisë për zhvillimin lokal për Komunën Rahovecit 2021- 2025;**
4. **Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P – 7151005 – 01054 – 0 në zonën kadastrale Krushë e Madhe;**
5. **Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënien në debat publik të Draft statutit për QKMF-në e Rahovecit;**
6. **Shqyrtimi i Raportit të performancës komunale për vitin 2020;**
7. **Të ndryshme.**

Të nderuar kollegë kuvendarë, a jeni për këtë rend dite. Konstatoj se unanimisht aprovohet rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës:

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush diçka rrëth procesverbalit, atëherë meqë nuk kemi e qesim në votim. Konstatoj se unanimisht aprovohet pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2021 – 2024.

Para se me marr fjalën z. Limani, unë dua të ju kërkoj falje publikisht pasi ka qenë një lëshim i imi i cili kornizën drejtori Afrim Limani ma ka dërguar në mes të muajit maj dhe duke menduar që ja kam dërguar Skender Hamzës që me ju përcjell juve me material bashkë me KAB-in, që realisht është bërë një lëshim prej meje. Kështu që gjithsesi kisha kërkuar mirëkuptimin tuaj dhe ne jemi munduar që qysh dje me ju dërgua edhe në e-mail edhe në kopje fizike.

Afrim Limani – Përvendetje për ju kryesues, nënkyetar, anëtarë të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm. Para se të ju shpjegoj buxhetin në vlera dhe shifra, paraprakisht desha të ju njoftoj se ne si drejtori e financave bashkë me të gjitha drejtoret, ne kemi përgatit KAB-in si dokument strategjik për 3 vitet e ardhshme. Konsideroj se në këtë dokument janë të përfshira të gjitha strategjitë, objektivat dhe nevojat për 3 vitet e

ardhshme dhe si dokument i tillë, si informatë nëse nuk keni pas kohë me lexua qarkoren buxhetore siç e tha edhe kryesuesi si dokument duhet të votohet nga ana e juaj. Para se ju me vërejt, do ju them se ne atë dokument janë disa gabime teknike që janë bërë mirëpo me theks të veçantë ju them se ne faqe 9-të është një gabim te numri i nxënësve, pasi numri i nxënësve është 10841 por duhet të jetë 9839 sepse kanë ngelur shënimet nga numri i nxënësve të vitit 2020. Po ashtu në faqe numër 15, si gabime teknike që janë bërë e që nuk guxojnë të bëhen mirëpo sigurisht se kam mirëkuptimin tuaj sa i përket këtyre gabimeve që për mbledhje të kuvendit gjithsesi do të korrigjohen, pra te pjesa e investimeve kapitale ku vlera ishte mbi 3 milion ndërsa realisht duhet me qenë 4,286,000 sepse edhe aty është bartur vlera pasi që nga viti i kaluar vlera e investimeve kapitale ka qenë pikërisht në atë vlerë për shkak se kemi pritur me u zbatua ligji mbi pagat edhe ajo nuk u bë kështu që ajo pjesë prej mbi 1 milionëve ka kaluar. Pra, buxheti i komunës paraprakisht ju njoftoj se qarkorja e parë buxhetore ka ardhur diku me datë 17 maj edhe aty janë përcaktuar limitet apo tavanet buxhetore dhe sasia e buxhetit në komunën e Rahovecit për vitin 2022 si dhe projekcionet për vitin 2022-2024. Buxheti i Komunës së Rahovecit për vitin 2022 në total është 15,053,660 euro. Nëse e krahasojmë buxhetin e vitit 2022 me vitin 2021 kemi një ndryshim pozitiv në total prej 837,000 euro dhe ndryshimi pozitiv në vlerë prej 327,372 euro është në kuadër të grantit të përgjithshëm të grantit të përfomancës. Pastaj, kemi një rritje të buxhetit në kuadër të grantit të arsimit në vlerë prej 220,118 euro dhe bashkë me rritjen e të hyrave vetanake nga viti 2022 do të kemi një planifikim real të të hyrave vetanake sepse siç e dini edhe ju sepse vazhdimisht kemi pasur probleme pasi siç e dimë, që këto limite i qet Ministria e Financave, që do te thotë buxheti ka ndryshim pasi të hyrat vetanake për vitin 2022 do të jenë 1,350,000 euro që ka një ndryshim nga viti 2021 në vlerë prej 289,455 euro, e që në total kemi rritje të buxhetit bashkë me të hyrat vetanake 837,000 euro. Duke ditur që tavanet dhe limitet janë caktuar sipas kategorive ekonomike në arsim dhe në shëndetësi atëherë ne si drejtori e financave në bazë të analizave tona i kemi përcaktuar përafërsisht edhe sa do të jetë buxheti në kuadër të kategorive ekonomike. Tash e presim edhe qarkoren e dytë buxhetore mirëpo nëse ka ndonjë lëvizje përafërsisht me vlera të vogla që nuk ndikojnë shumë në peshë p.sh. pagat 7,872,844 euro, pastaj mallra dhe shërbime 1,735,000 euro, shpenzimet komunale 270,000, subvencionet dhe transferet 360,000 dhe investimet kapitale do të jenë 4,815,786 euro. Pra, ndryshimi më i madh do të jetë në kuadër të investimeve kapitale që nëse bëjmë krahasim me periudhën e njejtë të vitit të kaluar janë përafërsisht 600,000 euro. Kështu që besoj që këto do të jenë edhe tavanet apo limitet kryesore sepse në qarkoren e dytë buxhetore nuk pres që do të ketë ndonjë ndryshim. Pra, si karakteristikë është se prej këtij buxheti kemi rritje të grantit të përgjithshëm 327,000, granti i arsimit 220,000, granti i shëndetësisë ka ngelur i njëjtë me vlerë të njëjtë sikur i vitit 2022 dhe të hyrat vetanake prej 289,455 euro, kështu që kemi një ndryshim prej 837,000 rritje të buxhetit në krahasim me këtë vit pra 2021. Tash do keni ju hapësirën në dispozicion për pyetjet tuaja.

Kryesuesi – Faleminderit shumë drejtor për prezantimin e KAB-it, ashtu siç e theksove edhe vetë se këtë vitë do të kemi rritje të buxhetit për aq sa është paraparë.

Rasim Fazliu – Përshëndetje për ju kryesues, nënkyetarin, për anëtarët e Komitetit për Politikë dhc Financa, drejtorët e drejtorive, përfaqësues të mediave, të LMT-së, OSBE-së dhe gjithë të pranishmit në sallë. E falënderoj drejtorin për prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të komunës së Rahovecit për vitet 2022-2024. Unë dua t'i them disa gjëra, e para është se më vjen mirë që kanë lëvizje këto limitet apo tavanet buxhetore sepse është planifikimi i të hyrave vetanake komunale edhe më i mirë edhe më real pasi që vitet paraprake e dini edhe ju që kemi pasur të hyra më të mëdha se ka qenë planifikimi kështu që nuk ishte në rregull ajo punë kurse tash po shihet që është më në rregull pasi dikush është dashur të thotë se i kemi tejkaluar planifikimet dhe mua nuk më pengon ajo, pasi vërtet unë i gëzohem suksesit të çdo qeverie sepse është në interesin e qytetarëve të komunës së Rahovecit mirëpo sigurisht se planifikimi me qenë me real do të ishte më mirë sigurisht. Kështu që mua me pëlqeu kjo që ka ndodhur që janë rritur planifikimi i të hyrave vetanake dhe kjo është diçka e mirë. Tani desha me pyet drejtorin pasi këtu në faqe 13, ku shkruan projekcionet e shpenzimeve buxhetore për vitin 2021 do t'i paraqesim sipas kategorive ekonomike, që për mbledhje të kuvendit do të ishte mirë me shkrura 2022 që ndoshta do të ishte më mirë. Edhe unë i analizova më shumë kujdes ashtu siç e thatë edhe ju se ka rritje në paga dhe mëditje mbi 13%, pastaj te mallrat dhe shërbimet kishte zvogëlime ashtu siç e potencuat ju. Kështu që pyetja është a i keni paraparë ju zvogëlimet

apo ata dhe gjithashtu subvencionet kishte rritje rreth 15.76% edhe sigurisht që është mirë që u bo kjo rritje pasi që ndoshta ka edhe nevojë edhe më tepër pasi që ndoshta edhe po duhet me marr në një kategori tjetër që me pas mundësi me i subvencionua bujqit apo qytetarët në përgjithësi që kanë nevojë. Gjithashtu edhe te investimet kapitale është mirë që ka rritje pasi që kemi nevojë, po ashtu edhe ne faqe 15 kërkoj një sqarim nga ju drejtore pasi ju i dhatë ato edhe sigurisht se i korrigjoni gabimet që i potencuat ju vetë, kështu që në tabelën 3 tek shpenzimet rrjedhëse që për vitin 2021 kanë qenë 10,830,050 euro kurse për vitin 2022 kemi rënien apo zvogëlim për 10,237,844, pastaj për vitin 2023 prapë është rritje dhe për vitin 2024 prape ka rënien, kështu që mua më intereson se pse ka shkuar kjo lako dhe kërkoj sqarime nga drejtori që më qenë i informuar.

Fehmi Cena – Përshëndetje për ju kryesues, për kolegë këshilltar nga KPF-ja, drejtor të drejtorive dhe gjithë te tjerët që janë prezantë në sallë. E falënderoj drejtorin e Financave për prezantimin e Kornizës Afatmesme Buxhetore të komunës së Rahovecit 2022-2024. Mendoj që me shpjegimet dhe korrigjimet teknike është qartë se ne i kemi vërejtur ato gabime teknike që janë bërë dhe besoj që në mbledhjen e ardhshme të kuvendit do të përmirësohen do të janë shifra të sakta edhe sigurisht se drejtori e prezantoi edhe në shënimë në kopje fizike e shohim që është një buxhet me rritje për vitin e ardhshëm në krahasim me vitin 2021, poashtu edhe granti qeveritar është pak në rritje dhe gjithashtu edhe planifikimi i të hyrave është pak më i lartë, pasi janë ato limitet që kërkohen në bazë të qarkores buxhetore. Kështu që pa i përsëritur ato që i tha parafolësi z. Fazliu, po me intereson se kjo është përgatitje e parë e Kornizës Afatmesme Buxhetore dhe mund të ketë edhe ndërhyrje shtesë e gjithashtu do të kemi në të ardhmen shqyrtim të hollësishëm. Te qarkorja buxhetore po thirremi në ato sugjerime dhe kërkesa që ata i kanë cekur që duhet të merren parasysh edhe në plan edhe në Kornizë Afatmesme Buxhetore është cekur se duhet të merren parasysh edhe obligimet që dalin nga kontrata kolektive dhe nuk e di a e keni vërejt dhe a e keni paraparë ose duhet me parapa pasi që në bazë të shifrave që unë i kam lexuar, nuk besoj që aty merr pjesë edhe ajo duke ditur që komuna ka obligime goxha të mëdha buxhetore për këtë çështje nëse i referohemi kontratës kolektive në arsim edhe në shëndetësi. Ne kemi bisseduar edhe më përparrë për pagat jubilare, për pagat shtesë pas pensionimit pasi aty ceket se duhet të merren parasysh. Pastaj, është edhe një pikë tjetër që theksohet qartë, te investimet ku do të planifikohet në fazën tjetër shpenzimi për investime kapitale dhe ajo që duhet të kihet parasysh më tepër kësaj here për keq klasifikime të mos ketë sepse ato nuk do të tolerohen, që edhe ajo është e qartë edhe një trajnim që kemi pasur nga KPF-ja na është thënë nga Ministria për Financa që pjesa e buxhetit që planifikohet nëse ka keq klasifikime tash e tutje nuk do të tolerohen dhe ajo pjesë e buxhetit mund të tërhoqet jo vetëm për projektet e reja por thuhet edhe për projektet në vazhdim. Mendoj se duhet të punoni si qeveri në të ardhmen që të mos kemi kundërthënie me qarkoren buxhetore, pasi me siguri që do të ketë edhe diskutime në kuadër të kuvendit nuk do të arrihet pëlqimi që ju do ta kërkoni prej delegatëve.

Afrim Limani – E filloj me pyetjen e parashtruar nga z. Rasim Fazliu rreth planifikimit edhe pse e keni mirëpritur mirë por paraprakisht ndoshta me dhëne një shpjegim se si rrjedhin këto. Konsideroj se sipas analizave tona për vitin 2022 do ta kemi një planifikim real të të hyrave duke marr parasysh edhe inkasimin që kemi bërë ndër vite dhe ju e dini që gjithmonë kemi nxjerrë një vendim për tejkalin të të hyrave që kemi bërë këtë dhe vite të tjera. Pra, ashtu siç kam thënë edhe më herët edhe tash këto limitet për të hyrat vetanake i cakton Ministria e Financave dhe unë do të ju lexoj një shembull, për një dokument se çka shkruan këtu dhe ne sipas atyre limiteve që vazhdimisht kemi bërë kërkesa që të hyrat të rriten mirëpo ata nuk i kanë marr parasysh rekomandimet tona dhe ka ngelur kështu. Kurse tash sigurisht e kanë pasur parasysh dhe konsideroj që kemi një planifikim real të të hyrave. Tash këtu e keni edhe në qarkore edhe mundeni me vërtetua se komuna e Rahovecit dhe janë në të gjitha komunat, se tatimi në pronë dhe në tokë duhet me qenë 702,000 euro pasi na kanë caktua një limit që ne mbi bazën e kësaj ne duhet me planifikua dhe mbas tatimit pjesa tjera që inkason komuna 648,433 euro. Pra, fillimisht duhet me qitë tatimin ne pronë dhe tatimin ne tokë dhe pjesa tjetër prej 1,350,000 duhet me planifikua në leje ndërtimore, licenca. Aktualisht e kemi tatimin ne parcela (oborre) edhe në male. Kjo ishte sa i përket planifikimit të hyrave vetanake kurse pjesa tjetër e pyetjes ishte te shpenzimet rrjedhëse të vitit 2021 në krahasim me vitin 2022 pse ka zvogëlim atje kurse realisht këtu ka rritje. Nuk hyjnë shpenzimet kapitale dhe ka që 3 vite që në fund të vitit po ballafaqohemi edhe me një problem që ka tepricë apo deficit në mallra dhe shërbime e sidomos në arsim mirëpo edhe në

kuadër të disa drejtorive, kështu që kemi pasur problem edhe me i shpenzua. Pra, tash konsideroj se kemi bërë një planifikim real edhe i kemi zvogëlua mallrat dhe shërbimet dhe janë rrit pak kategoria e subvencioneve dhe investimeve kapitale. Projekcionet është një lloj formaliteti që ata na caktojnë limitet psh për vitin 2022 dhe ne duhet me plotësuar buxhetin sipas tyre pasi që vazhdimisht bazë është viti i ardhshëm kurse ato tjerët vazhdimisht kanë ndryshuar dhe konsideroj që nuk është një projekzion real që do të ndodhë vitin e ardhshëm dhe kjo është arsyja që janë zvogëluar tek mallrat dhe shërbimet sepse kemi problem me deficit në fund të vitit fiskal. Po ashtu te investimet kapitale ne i kemi rritur për vitin 2022 afersisht për 50,000 euro duke parë që ne kemi nxjerrë një vendim për subvencionimin e lindjeve dhe mbi bazën e saj që kemi bërë një analizë si drejtori e financave dhe në bazë të disa statistikave përafersisht atë vlerë e kemi rrit subvencionet që duhet t'i takojnë drejtorisë së shëndetësisë. Pastaj, pyetja e parashtuar nga z. Cena nga kontrata kolektive në arsim, shëndetësi, paga jubilare. Sipas ligjit të financave dhe përgjegjësive këto nuk planifikohen në buxhet mirëpo qeveria mundet me bo edhe këtë sepse para se me u bo drafti i parë i buxheit mblidhet një komision që i shqyrtton kërkeshat, bën analiza edhe i qesin në draftin e parë. Kështu që ne përmes Asociacionit të Komunave, komuna jonë bashkë edhe shumë komuna tjera në nivel vendit i kemi adresuar një kërkeshë që mjetet që rrjedhin nga kontrata kolektive të buxhetohen, pra, para se me dal drafti i parë dhe të ju them të drejtën unë si drejtor e kam ditë që pak kam shpresua edhe ashtu ndodhi dhe realisht atë nuk e kanë shti në planifikimet buxhetore. Tjetër mënyrë ne si organizatë buxhetore, si komunë nuk guxojmë asgjë me planifikua këtu pasi ne i referohemi ligjit të financave publike dhe përgjegjësive si dhe ligjit të buxhetit që del tash për vitin 2022. Këto gjera edhe nuk kemi të drejtë edhe sot me dashtë me i pagua dhe është shumë problem kjo punë, por unë kam menduar dhe më herët kam deklaruar që brenda këtij viti që në tetor që është procesi i ridestitimit që e dini edhe ju, që besoj që do të kemi teprica nga pozicioni i pagave të paktën me zbutë pak pasi që kemi shumë lëndë që na kanë paditur neve si komunë në gjykatë. Mënyrë tjetër nuk kemi mundësi se qysh me i pagua këta, Siç e thatë edhe ju më herët nëse këto mjete hargjohen përmes përmbaruesit apo gjykatave ato automatikisht shkojnë te keq klasifikimi i pasqyrave financiare. Pra, këtë problem e kemi ne dhe shumë komuna tjera dhe kemi kërkuar që përmes asociacionit që këto pagesa që i bëjmë mos ta marrin formën e keq klasifikimit dhe të mos ndikojnë në pasqyrat financiare, se çka bëhet me tutje nuk e dimë, pasi secila komunë i ka specifikat e veta p.sh. te ne këtë vit e keni parë numrin e nxënësve, formula për ndarjen e grantit të arsimit shkon sipas një formule që është në përpjesëtim nxënës mësimdhënës, pasi numri i nxënësve vazhdimisht ka rënie që nga viti 2020 deri më 2022 në bazë të statistikave afersisht 1000 nxënës që kemi mungesë. Atëherë, duke ditur që buxheti ndahet sipas kësaj formule nxënës mësimdhënës i bie që të paktën mbi 100 mësimdhënës me u largua nga puna, varet prej karakteristikave, numrit të nxënësve që ka secila shkollë sipas kësaj formule dhe ne nuk po e bëjmë atë veprim dhe atëherë realisht buxheti po zvogëlohet në bazë të formulës por ne po i paguajmë ata mësimdhënës dhe këtu është deficiti buxhetor që vazhdimisht po krijohet dhe ne po duhet me pagua çdo herë dhe po kemi minus në arsim. Kështu që këtë problem ka disa komuna tjera që nuk e kanë p.sh. Skenderaj që përafersisht edhe me sipërfaqe është i njëjtë sikur komuna jonë mirëpo ajo nuk ka problem dhe ka arrit mc i pagua pjesë pjesë mc kohë kurse ne as me pjesë pjesë nuk po kemi mundësi. Dhe ne për me i krye këto në bazë të një kalkulimi që kemi bërë si drejtori e financave diku 2,600,000 euro dhe ne përmendim e pagua këtë kategori atëherë duhet 1 vit mos me pas investime askund. Dhe përmendimin tim në momentin kur nënshkruhet një kontratë që ka reflektim financiar ajo duhet me u bisedua dhe nëse jo në atë vit atëherë vitin e ardhshëm kurse ata kanë nënshkrua kontratë që ka reflektim financiar kurse realisht buxhet s'kanë ndarë për atë kategori dhe realisht janë ata akterët që e kanë nënshkruar atë kontratë dhe ata duhet me pagua dhe me marr përsipër dhe këtë rast e kemi me qeverinë, me ministrinë e arsimit dhe qeverinë, me ministrinë e shëndetësisë mirëpo ata krejt barrën e kanë bartë te komunitat.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për të gjitha sqarimet, atëherë më që nuk po shoh tjerë të lajmëruar sa i përket kësaj pike, konstatoj se kalon përmendim e kuvend pika e dytë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi i Draft strategjisë për zhvillimin ekonomik lokal për Komunën e Rahovecit 2021 – 2025.
Artan Asllani – Përvendetje për të gjithë. Para jush keni draft strategjinë e zhvillimit ekonomik lokal për periudhën 2021-2025, ku komuna e Rahovecit ka marr këtë iniciative të bën edhe këtë draft strategji për

shkak se edhe e rrit transparencën komunale dhe është një dokument që jep orientim për qeverisjen lokale rrith zhvillimeve që pritet të ndodhin në komunën e Rahovecit. Në këtë material kanë dhanë kontribut të gjitha drejtoritë komunale dhe grupet e interesit, qytetarët dhe deri më tani i ka kaluar të gjitha debatet publike dhe janë marr te gjitha komentet ku janë shqyrtuar dhe analizuar dhe janë përfshirë në këtë strategji. Kështu që pres nga ju nëse ka diçka sa i përket kësaj draft strategjie.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, po është shumë vërtetë edhe në mbledhjen e kaluar e kemi bo aprovimin për dalje në debat publik dhe i ka kryer të gjitha procedurat ligjore dhe mendoj që i ka pasur disa komente që realisht janë implementuar në draft strategji.

Rasim Fazliu – E falënderoj drejtorin për sjelljen e kësaj draft strategje të zhvillimit ekonomik lokal në komunën e Rahovecit për vitin 2021-2025. Unë veç desha me pyet drejtorin që gjatë debatit publik që ju ka nënshtruar a ka pasur ndonjë lëvizje që ka kontribuar dikush dhe që është futur këtu, kur është dhënë ne fillim kjo draft rregullore, që a ka pasur ndonjë plotësim apo sugjerim.

Artan Asllani – Po i nderuari z. Rasim Fazliu gjatë shqyrtimit në debat janë marr të gjitha sugjerimet apo edhe kritikat dhe të gjitha ato janë shqyrtuar dhe analizuar dhe janë futur në këtë material. Sipas debatit fokus kryesor ka qenë të jepet sektorit të bujqësisë në komunën e Rahovecit ku janë përcaktuar të gjitha të dhënat aty dhe janë vendos në këtë material.

Rasim Fazliu – Do te ishte mirë që ndoshta për mbledhje të kuvendit t'i marrësh ato shënime dhe të na prezanton që keni pasur këtë draft rregullore në fillim dhe kuvendi i ka dhënë leje për debat publik dhe gjatë debatit këta persona kanë dhënë propozimet e tyre dhe ai propozim ka qenë me vend dhe ka hyrë në këtë draft rregullore që me pas mundësi me pa dhe ne se diçka është bërë në këtë drejtim.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon për kuvend edhe pika e tretë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Shqyrtimi i Propozim vendimit të Kryetarit për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P - 7151005-01054-0 në zonën kadastrale në Krushë të Madhe.

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues, të nderuar drejtor, anëtar të KPF-së dhe gjithë ju të pranishëm në sallë. Para jush keni propozimin e kryetarit të komunës për shpalljen me interes të përgjithshëm publik P-7151005-01054-0 në zonën kadastrale në Krushë të Madhe. Bëhet fjalë për parcelën e cila është pronë shtetërore e Kosovës KK Rahovec, ujërat me sipërsaqe prej 6.48 m². Qëllimi shpalljes së interesit të përgjithshëm, jemi në fazën e projektimit të një projekti i cili do të rregulloj qendrën e fshatit në Krushë të Madhe dhe kemi një arsyë tjetër më të madhe se kjo pasi që KRU Gjakova na ka paditur për këtë parcelë dhe po kërkon autorësinë, pronën e kësaj parcele dhe neve do të na shërbej për procedura gjyqësore që ky vendim që shpallet në zonën me interes të përgjithshëm që të ju bëjmë me dije aty se ne e kemi për interesat e qytetarëve të asaj zone që do ta bëjmë një park dhe do ta zgjerojmë hapësirën gjelbëruese dhe po mundohemi me mbrojt këtë pronë prej agjensionit KRU Gjakova. Ftoj anëtarët e KPF-së që të votojnë për propozimin e kryetarit për shpalljen e interesit të përgjithshëm. Pra, bëhet fjalë për një shtëpi në Krushë të Madhe e cila gjendet në qendër e cila çshëtë afër një objekti i cila ka qenë depo që nc e kemi rrënuar nië herët. Kjo shtëpi e cila ka qenë e shfrytëzueshme prej KRU Gjakovës dhe tash aty banon një zonë dhe është një oborr që ka disa gypa dhe ata kanë bërë padi ndaj komunës dhe po kërkojnë me vërtetua pronësinë e kësaj parcele.

Dervish Çadraku – Më intereson me dit te kjo pjesë pasi e di që ka pasur disa pretendentë privat si pronar të saj dhe është përfolë që me duket që ka pasur edhe procese gjyqësore që nuk jam shumë i sigurt, por, a është rregullua edhe kjo si problem i kësaj prone pasi ata gjithmonë mund të kërkojnë me kthyë atë pronë në private siç e kanë pasur edhe në të kaluarën nëse ka qenë private e them kushtimisht pasi është përfol se ka pasur pretendime se është pronë private dhe ka pasur edhe fërkime sa i përket asaj prone. Kështu që më intereson me ditë se a është krye ky problem i pronësisë të atij personi privat.

Afrim Oruqi – Parcelsa ku ka qenë e ndërtuar depoja dhe kjo parcelë janë krejt prona private dhe janë marr prej pronarëve dhe ka disa vendime që dikush është këmbyer me pronë dhe dikush është kompensuar me shpronësim mirëpo ne sillemi si autoritet me certifikatë te pronës dhe këto figurojnë prona te komunës edhe pse ka pasur pretendime mirëpo asnjëherë nuk ka pasur padi edhe për parcelën që është shfrytëzuar si depo por edhe për parcelën ku ka qenë e shfrytëzuar nga KRU Gjakova. Pronaret vazhdimisht e kanë potencuar se kanë qenë prona të tyre dhe që ju janë marr dhe qendra e fshatit ku është dhe jo krejt janë shpronësuar por

komuna e Rahovecit i ka në certifikata të pronës dhe i menaxhon këto prona deri me një vendim tjetër kur ata i fitojnë dhe padi nuk ka dhe ne ekzekutojmë aktgjykimin e përkthejmë pronën dhe ju kthejmë privateve, nëse këtë e vërteton gjykata.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor për sqarimin, atëherë meqë nuk kemi tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon përvend edhe pika e katërt e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e pestë të rendit te ditës:

5. Shqyrtimi i Propozim vendimit për vënie në debat publik të Draft statutit për QKMF-në e Rahovecit.

Samir Mustafa – Para jush e keni statutin e hartuar nga ministria e Shëndetësisë dhe është statut unik që e ka hartuar ministria për të gjitha komunat e Kosovës. Kështu që për hir të transparencës kërkojmë nga leje përvend në dëgjim publik të statutit të QKMF-së në Rahovec “Fahredin Hoti”.

Fehmi Cena – Faleminderit kryesues, edhe unë po dua të kontribuoj që me sqarua për hir të delegatëve tjerë sepse është çështja e statutit të shëndetësisë që ka të bëjë me shëndetësinë dhe meqenëse unë kam qenë drejtor i shëndetësisë më herët dhe kjo është hera e tretë që faktikisht i referohemi statutit të QKMF-së me disa plotësim ndryshime dhe herën e parë diku ka viti 2004-2005 ka pas dalë statuti i parë dhe unë kam qenë pjesë e grupit punues në nivel Kosove, që edhe ai ka qenë në nivel te Kosovës, mirëpo pastaj nëpër komuna ka pësuar pak ndryshime dhe po ashtu edhe herën e dytë ka viti 2015 që ka qenë drejtor i Shëndetësisë Munib Durguti ka pasur disa ndryshim plotësime dhe që ka qenë realisht një statut që është punuar deri tash. Dhe tash është kjo hera e tretë që po kërkohen disa plotësim ndryshime apo të definohet sepse nëpër komuna kanë pësuar ndryshime kuvendet komunale dhe ndoshta diçka ka ardhur edhe në kundërshtim me nivelin qendror dhe tash si duket niveli qendror si ministria apo qeveria po kërkon që te jetë plotësish unik në nivel të Kosovës. Por unë e kisha pyetur drejtorin pasi që ai e ka studiuar pak me mirë këtë statut dhe a ka ndonjë ndryshim kruçial i këtij statuti në raport me statutin që ka qenë deri tash në fuqi, që me na dhanë një përgjigje tani apo përmbladhje të kuvendorit, pasi unë i kam vërejt disa ndryshime por unë tani po rezervohem dhe ndoshta i keni vërejt edhe ju që realisht nuk janë ndryshime të mëdha por ndoshta duhet cekur pastaj kur do të marrim vendimin si kuvend komunal që kjo me qenë dokument final që rregullon statutin e QKMF-së dhe të gjitha institucioneve shëndetësore të kujdesit parësor, pra në këtë rast në komunën tonë.

Samir Mustafa – Sa i përket ndryshimeve nuk janë të mëdha, ato janë ndryshime kozmetike dhe është formuar grapi punues për hartim ndryshim plotësimin dhe pas adaptimit të statutit nga ana e drejtorisë së shëndetësisë pastaj statuti dërgohet përmbladhje të kuvendorit, pasi unë i kam vërejt disa ndryshime por unë tani po rezervohem dhe ndoshta i keni vërejt edhe ju që realisht nuk janë ndryshime të mëdha por ndoshta duhet cekur pastaj kur do të marrim vendimin si kuvend komunal që kjo me qenë dokument final që rregullon statutin e QKMF-së dhe të gjitha institucioneve shëndetësore të kujdesit parësor, pra në këtë rast në komunën tonë.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor të gjitha sqarimet, atëherë nëse nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon per kuvend edhe pika e pestë e rendit të ditës. Kalojmë ne pikën e gjashtë të rendit të ditës:


6. Shqyrtimi i Raportit të Performances komunale për vitin 2020.

Të ndcruar anëtarë të KPF-së, në mungcsë të pjesëmarijes së zyrtarës për performancë Bjondina Ramaj për prezantimin e raportit mirëpo përmbladhje te kuvendorit sigurisht se do te jetë prezente dhe sigurisht se do ta përgatisë ashtu siç duhet raportin, por ka kërkuar mirëkuptimin tuaj. Ju veç e keni pjesën e materialit rrëth raportit të performancës kështu që kisha kërkuar që përmbladhje te kuvendorit me qenë një raport ashtu siç duhet me qenë nga znj. Biondina Ramaj që është përgjegjëse për performance.

Rasim Fazliu – Faleminderit kryesues, unë po i referohem këtij dokumenti që kam përparrë që ndoshta ata e kuptojnë që e kanë hartuar këtë por p.sh. këtu thotë treguesi 5.1 hapësira për aktivitete sportive përmbladhje të banorëve 78.06, unë e mora këtë shembull por krejt njësoj janë. Kështu që kërkohet që përmbladhje te kuvendorit me tregua se çka ka bërë komuna e Rahovecit dhe të gjitha ato gjëra që ka marr vendin e merituar për performance dhe me u mundua me pika të caktuara përmbladhje te kuvendorit me qenë një raport ashtu siç duhet me qenë nga znj. Biondina Ramaj që është përgjegjëse për performance.

Kryesuesi – Faleminderit z. Fazliu, mendoj që përmbladhje te kuvendorit do te jetë i kompletuar rapporti i performancës ashtu si duhet me qenë. Atëherë meqë nuk ka tjerë të lajmëruar, konstatoj se kalon përvend edhe pika e gjashtë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e shtatë të rendit të ditës:

7. **Të ndryshme.** Të nderuar anëtarë të KPF-së, dëshiroj të ju njoftoj se për mbledhje të kuvendit do ta kemi edhe raportin e kryetarit për 6-mujorin e parë, që zakonisht e kemi bërë në mbledhjen e muajit korrik por kanë kërkuar që për mbledhjen e qershorit me u krye rapporti për 6-mujorin e parë të kryetarit.
8. **Rasim Fazliu** – Faleminderit kryesues, unë desha me ngritë një çështje rreth obligimeve që i paguajmë ndaj komunës rreth tatimit p.sh. unë dua me fol për veten time që këto realisht janë përsërit edhe për të gjithë banorët e komunës së Rahovecit si në qytet ashtu edhe nëpër fshatra p.sh. unë parcelën kur kam shtëpinë e ndërtuar dhe sigurisht se e di edhe sipërfaqen sa e kam te parcelës dhe sigurisht se kur është bërë fotografimi nga ajri, i kanë regjistruar edhe shumë parcela tjera pjesë të parcelës time dhe tash unë paguaj tatim për ato parcela që nuk janë te miat, pasi aty janë më shumë se 7- hisëtar dhe këtë çështje unë po e ngrisë këtu në mënyrë që për mbledhje të kuvendit me na dhanë një përgjigje, që ne te kundërtën nuk mundem me pagua me shumë sa e kam në posedim pjesën time dhe jam përgjegjës vetëm për pjesën time dhe jam pronar i saj. Kështu që po kërkoj nga ju që të ngritet kjo çështje edhe përmirësohen këto gabime, që të mos e pësoj asnjë qytetar që me pagua për pjesën që nuk e ka në posedim, pasi nuk po mundem me pagua tatimin për shkak të ngarkesës që me është bërë. Kështu që problemi ekziston te ata që në mënyrë paushallë kanë punuar dhe janë ngarkuar pa të drejtë me obligime. Kërkoj nga qeverisja komunale me ngritë këtë çështje dhe me marr masa e me rregullua këtë problematike, pasi duhet te i shkruhet vetëm për atë që posedon dhe për atë parcelë bëhet pagesa. Pra, jam i gatshëm me pagua çdo here atë që e kam ne posedim, e jo me u ngarkua për atë çka nuk është e imja, kështu që mendoj se kërkesa është e drejtë dhe reale.
9. **Kryesuesi** – Faleminderit z. Fazliu, mendoj që është kërkësë me vend. Të nderuar kolegë të KPF-së duke ju falënderuar te gjithëve për kontributin e dhënë dhe shihemi në mbledhjen e radhës.

Procesmbajtësi,

 Agim Hoti

